



SBASHK Arsimimi sot

Nëntor, 2025

Gazeta elektronike

SBASHK mbajti trajnim për trajnerët dhe udhëheqësit e sindikatës së nivelit komunal



SBASHK gjatë muajit nëntor ka organizuar një trajnim për përfaqësuesit e sindikatës në nivel komunal dhe sindikalistët e rinj, në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social”. Në trajnimin katërditor mori pjesë edhe kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj, i cili mbajti një fjalë rasti, ku i inkurajoi pjesëmarrësit për zhvillimin e dialogut social në kuadër të sindikatës, por edhe zhvillimin e një dialogu të mirëfilltë sindikatë-punëdhënës. ë ditën e parë të trajnimit, po ashtu, zyrtarja për programe në Qendrën e Solidaritetit, Bruna Hylviu, qendër kjo e cila edhe e mbështeti trajnimin, bëri një... (faqe 4)

SBASHK dorëzoi kallëzim penal ndaj Ministrit në detyrë, Hekuran Murati



SBASHK ka dorëzuar kallëzim penal në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, te Departamenti i përgjithshëm, ndaj ministrit në detyrë, Hekuran Murati, për shkak të dyshimit të bazuar të keqpërdorimit të detyrës zyrtare, duke mos... (faqe 6)

Nëntori i kujtesës për ngjarjet dhe personalitetet e shquara



Nëntori është nga muajt që sjell kujtesën në ngjarjet e mëdha dhe.... (faqe 2)

Intervistë me kryetarin e NSKAP-it për Rahovec, Mehmet Kryeziu



Mësimdhënësit në Rahovec ballafaqohen me mungesë të nxënësve, u rrezikohen vendet e punës.... (faqe 3)

SBASHK, pjesëmarrës në Konferencën Rajonale në Mal të Zi



Përfaqësuesit e SBASHK-ut, anëtari i Kryesisë, Blerim Mehmeti, dhe kryetari i Komisionit Statutor, Blendor Shatri, kanë marrë pjesë në Konferencën ... (faqe 6)



Editorial

Nëntori i kujtesës për ngjarjet dhe personalitetet e shquara



Nëntori është nga muajt që sjell kujtesën në ngjarjet e mëdha dhe personalitetet e shquara të historisë sonë kombëtare, nëpër vite e shekuj. Më 14 nëntor të vitit 1908 nisi një ngjarje e madhe e kombit tonë. Njerëz të pendës filluan të vënë në jetë alfabetin e gjuhës sonë, duke mundësuar kështu penave të arta që veprat e tyre t'i shkruajnë me alfabetin shqip.

Në nëntor lartësojmë kujtimin për një ngjarje të madhe. Nëntori na kujton edhe datën 28 të vitit 1912. Na kujton Vlorën dhe plakun e urtë Ismajl Qemajli. Na kujton flamurin kombëtar. Në çdo 28 nëntor, shqiptarë nga gjithë trojet etnike lartësojnë kujtimin për këtë ngjarje madhore, përmes fjalës së thënë bukur dhe

këngëve të kënduara për flamurin dhe pavarësinë. Pikërisht në këtë muaj shpaloset para nesh figura emblemë e komandantit legjendar Adem Jashari, që me luftë e sakrifica i ndryshoi kahet historisë dhe me gjak vulosi ardhmërinë tonë dhe lirinë.

Në këto data të shënuara, kudo në shkollat e Kosovës vërehet atmosfera e krenarisë. Nxënësit bashkë me mësimmshënësit e tyre, me flamuj kombëtar e me vizatimet e fotografitë e figurave emblemë, zbukurojnë ambientet shkollore dhe jehon vargu dhe kënga për Ismajlin, Isën e Ademin.

Nëntori ishte dhe mbetet muaj i kujtesës dhe krenarisë për datat dhe ngjarjet e mëdha të historisë sonë kombëtare.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonjë rubrike në interes të antarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi SOT.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbimi të antarësisë, së shpejti do të oftojmë shërbime këshilla për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në uebfaqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: **Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)** përfaqëson mbi 24.000 anëtarë në tërë territorin e Kosovës duke përfshirë edhe komunitetet, SBASHK është anëtare e Edukimit Ndërkombëtar që nga viti 1996 me drejta të plota.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel: +383 (0) 38 226 940



Intervista

Intervistë me kryetarin e NSKAP-it për Rahovec, Mehmet Kryeziu



Mësimdhënësit në Rahovec ballafaqohen me mungesë të nxënësve, u rrezikohen vendet e punës.

Niveli Sindikal Komunal i Arsimit në Rahovec (NSKAP) e ka zgjedhur kryetarin e ri. Mehmet Kryeziu, i cili më parë ka qenë kryetar i Nivelit të Shoqatës Sindikale në Rahovec, ka synime për mbrojtjen e interesave të mësimdhënësve edhe më shumë në nivelin komunal të sindikatës. Në një intervistë për gazetën “Arsimimi sot”, Kryeziu ka thënë se mësimdhënësit në Rahovec përballen me shumë probleme sa i përket procedurave për avancim, rënies së numrit të nxënësve dhe rrezikut për humbjen e vendeve të punës. Ai ka theksuar se mësimdhënësit kanë mungesë të trajnimeve adekuate të cilat i ofron sistemi arsimor, ndërsa trajnimet që SBASHK-u i organizon pa pagesë për mësimdhënësit janë shumë të nevojshme dhe të mirëseardhura. Më gjerësisht, mund të lexoni intervistën e plotë të muajit nëntor me kryetarin e sapozgjedhur të NSKAP-it në Rahovec, Mehmet Kryeziun.

SBASHK: Cili është qëllimi i kandidimit dhe zgjedhjes tuaj në krye të Nivelit Sindikal Komunal të Arsimit Parauniversitar (NSKAP) në Rahovec?

Kryeziu: Kam kandiduar për kryetar të sindikatës së arsimit në nivel komune (NSKAP), sepse besoj se përvoja ime shumëvjeçare si kryetar i shoqatës sindikale në nivel shkolle më ka përgatitur mjaftueshëm të përfaqësoj me përgjegjësi dhe seriozitet interesat e mësimdhënësve në

komunën e Rahovecit. Gjatë këtyre viteve kam punuar vazhdimisht për të mbrojtur të drejtat e punëtorëve të arsimit, për të ndërtuar bashkëpunim të fortë me kolegët dhe për të siguruar që zëri i tyre të dëgjohet.

SBASHK: Cilat janë synimet tuaja për zhvillim dhe rritje të sindikatës në komunën tuaj?

Kryeziu: Tani, në nivel komunal, synimi im është të forcoj edhe më shumë pozitën e mësimdhënësve, të avokoj për kushte më të mira pune dhe të kontribuoj në një dialog më të drejtë me institucionet komunale. Besoj se përmes përvojës, përkushtimit dhe transparencës mund të ndërtojmë një sindikatë më të fuqishme duke rritur numrin e anëtarëve dhe një sistem arsimor më të drejtë për të gjithë.

SBASHK: Sa ka interesim dhe nevojë për vijueshmërinë e trajnimeve të cilat i ofron SBASHK-u nga mësimdhënësit e Rahovecit?

Kryeziu: Interesimi dhe nevoja për vijueshmërinë e trajnimeve të organizuara nga SBASHK-u nga mësimdhënësit e komunës së Rahovecit është i lartë për disa arsye. Mësimdhënësit kanë obligim ligjor që të plotësojnë një numër të caktuar të orëve të Zhvillimit Profesional për avancim në karrierë, përtrirje të licencës së karrierës së mësimdhënësit, ngritje të kompetencave profesionale etj. Kjo rrit natyrshëm kërkesën për trajnime të akredituara si ato të SBASHK-ut, shumë prej të cilave pranohen për pikët e kreditimit, prandaj mësimdhënësit i shfrytëzojnë me interes të madh.

SBASHK: Cilat janë problemet me të cilat ballafaqohen mësimdhënësit në Rahovec e të cilat synoni t'i adresoni përmes mekanizmave sindikalë?

Kryeziu: Nga ajo që raportohet nga shkollat, mësimdhënësit e komunës së Rahovecit kanë nevojë më së shumti për trajnime që lidhen me përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie, metodat bashkëkohore të mësimdhënies, menaxhimin e klasës dhe komunikimin me nxënësit, si edhe dialogun social. Mësimdhënësit në Rahovec, ashtu si në shumë komuna të tjera të Kosovës, përballen me sfida të ndryshme që ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e mësimdhënies dhe mirëqenien profesionale. Këto probleme zakonisht adresohen përmes mekanizmave sindikalë të SBASHK-ut në nivel shkolle, komune dhe në nivel qendror. Më të theksuarat janë mungesa e trajnimeve cilësore, procedurat jo të qarta për avancim në gradat e karrierës, rënia e numrit të nxënësve sidomos nëpër fshatra dhe rreziku i humbjes së vendeve të punës për shkak të këtij fenomeni.

GJATË MUAJIT

SBASHK me trajnim për forcimin e dialogut social

SBASHK mbajti trajnim për trajnerët dhe udhëheqësit e sindikatës së nivelit komunal



SBASHK gjatë muajit nëntor ka organizuar një trajnim për përfaqësuesit e sindikatës në nivel komunal dhe sindikalistët e rinj, në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social”.

Në trajnimin katërditor mori pjesë edhe kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, i cili mbajti një fjalë rasti, ku i inkurajoi pjesëmarrësit për zhvillimin e dialogut social në kuadër të sindikatës, por edhe zhvillimin e një dialogu të mirëfilltë sindikatë-punëdhënës.



Në ditën e parë të trajnimit, po ashtu, zyrtarja për programe në Qendrën e Solidaritetit, Bruna Hylviu, qendër kjo e cila edhe e mbështeti trajnimin, bëri një prezantim të objektivave dhe agjendës së trajnimit, si dhe u zhvillua diskutim i lirë.

Gjatë këtij trajnimi u diskutua se çfarë është dialogu social – përkufizimi, zhvillimi dhe sfidat kryesore. Ndërsa, me temë: “Rëndësia e dialogut social për sindikatat dhe punëtorët në sektorin e arsimit”, një ligjëratë u mbajt nga trajneri Safet Beqiri.



Gjatë trajnimit, përfaqësuesit e SBASHK-ut, nënkryetarja Vjollca Shala dhe sekretari i Përgjithshëm, Ymer Ymeri, shtjelluan temën “Dialogu Social Kombëtar, Partnerët dhe interesat e tyre”, ku u diskutua eksperiencia e SBASHK-ut në përfaqësimin e mësuesve dhe punonjësve të arsimit në mekanizmat e dialogut kombëtar.



Gjatë trajnimit u mbajtën edhe ushtrime praktike rreth identifikimit të interesave të punëtorëve, interesave të punëdhënësve dhe qëllimeve të përbashkëta. Po ashtu, u dhanë shembuj nga përvoja e SBASHK-ut në negociata dhe bashkëpunim me institucionet publike, të cilat u prezantuan nga përfaqësuesit e SBASHK-ut.



Ndërkohë, në trajnim u mbajt ligjëratë edhe sa i përket Dialogut Social Evropian, rreth Këshillit Evropian të Punës dhe funksioneve të tij. Në kuadër të këtij diskutimi, ligjëratat me temën “Mundësitë që sindikatat e arsimit të angazhohen në platformat evropiane të dialogut” u mbajt nga trajneri Alban Zeneli.



Gjatë trajnimit u diskutua edhe sa i përket Këshillit Ekonomik Social në Kosovë, strukturës, funksioneve dhe organeve kryesore të tij. Me temë “Roli i BSPK-së/ SBASHK-ut në KES-në dhe në përfaqësimin e sektorit të arsimit”, ligjëratë mbajti trajneri Safet Beqiri. Ndërsa, rreth Dialogut Social Evropian – përkufizimi, funksionimi dhe përfshirja e sindikatës, ligjëratë mbajti trajneri Alban Zeneli, me titull “Praktikat e mira nga sindikatat evropiane të arsimit”.



Një ndër temat e diskutimit gjatë këtij trajnimit ishte edhe “Strategjitë e konfliktit dhe zgjidhjes”, e cila u mbajt nga zyrtari ligjor në SBASHK, Blendor Shatri, ku u trajtua përkufizimi i konfliktit dhe metodat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në vendin e punës. Në këtë kontekst, u dhanë shembuj të rasteve të SBASHK-ut për menaxhimin e konflikteve në sektorin e arsimit.



Gjithashtu, u mbajt një ushtrim praktik në grup me temë: “Trajtimi i konflikteve të përditshme të lidhura me sindikatat dhe identifikimi i zgjidhjeve”, i cili u zhvillua nga pjesëmarrësit.



Në fund të trajnimit, u dhanë vlerësime, përmbledhje të rezultateve dhe reflektim mbi rolin e SBASHK-ut në forcimin e dialogut social.

SBASHK dorëzoi kallëzim penal ndaj Ministrit në detyrë, Hekuran Murati

1

Republika e Kosovës - Republic of Kosovo

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture
Rr. Agim Ramadani p.m. Qendra e Studimeve 10000 Prishtinë, Tëlfax: +383(0)38/226-940,
info@sbashk.org E: sbashk2004@yahoo.com, info@sbashk.org

PROKURORISË THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

Në bazë të nenit 80 par 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), të cilën e përfaqëson me autorizim zyrtari ligjor Blendor Shatri.

KALLËZIM PENAL

Kundër të dyshuarit: Ministrit të Financave, punës dhe transfereve të Republikës së Kosovës, z. Hekuran Murati.

SEPSE

Për shkak të dyshimit të bazuar për kryerjen e veprës penale: **Keqpërdorimi i pushtetit apo autoritetit zyrtar** – neni 414, paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës

I. Përshkrimi i fakteve dhe veprimeve të kundërligjshme

Ekziston dyshimi i bazuar se që nga fundi i vitit 2022, kur ka skaduar mandati i Këshillit Ekonomiko-Social të Republikës së Kosovës, Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, z. Hekuran Murati, nuk ka vepruar në përputhje me kompetencat ligjore për të iniciuar formimin e Këshillit të ri Ekonomiko-Social (KES), siç e parashihet Ligji Nr. 04/L-008 për Këshillin Ekonomiko-Social.

Mosveprimi i tij përbën shkelje të detyrave zyrtare, duke cenuar funksionimin e një organi të pavarur, demokratik dhe ligjor për dialogun social ndërmjet punëdhënësve, të punësuarve dhe qeverisë.

II. Baza ligjore

Neni 3 – Qëllimi i themelimit të Këshillit Ekonomiko-Social

Këshilli Ekonomiko-Social (KES) themelohet me qëllim të vendosjes dhe zhvillimit të dialogut social në Republikën e Kosovës, për të punësuarit dhe punëdhënësit, për çështje të rëndësishme të veçantë që lidhen me realizimin e të drejtave të tyre ekonomike, sociale dhe profesionale.

Republika e Kosovës
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
Prokurori i Shtetit / Drжавni Tužilac / State Prosecutor
Prokuroria Themelore Prishtinë / Osnovno Tužilaštvo Prishtina / Prishtina Basic Prosecution

Numri i dokumentit: 04097171

ZYRA E PRANIMIT

BLENDOR SHATRI më datën 11.11.2025 në ora 09:16 në Prokuroria Themelore Prishtinë dorëzoi këto dokumente:

Lloji i dokumentit	Nr. i dokumentit	Data e dokumentit	Nr. i faqeve
Kallëzim Penal	2275/I	11.11.2025	4

Tjera:
NGA SBASHK

Dorëzoi:
BLENDORSHATRI

Pranoi:
Besim Fejzullahu

SBASHK ka dorëzuar kallëzim penal në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, te Departamenti i përgjithshëm, ndaj ministrit në detyrë, Hekuran Murati, për shkak të dyshimit të bazuar të keqpërdorimit të detyrës zyrtare, duke mos vepruar sipas Ligjit për Këshillin Ekonomik Social, duke mos shpallur që nga fundi i vitit 2022 ftesën për formimin e këtij Këshilli, për çka është i obliguar ligjërisht. Me këtë mosveprim, Murati ka shkaktuar

SBASHK, pjesëmarrës në Konferencën Rajonale në Mal të Zi

Përfaqësuesit e SBASHK-ut, anëtari i Kryesisë, Blerim Mehmeti, dhe kryetari i Komisionit Statutor, Blendor Shatri, kanë marrë pjesë në Konferencën Rajonale në Mal të Zi, ku po diskutohet Ligji për Grevën dhe përvojat krahasuese të vendeve të rajonit.

Me këtë rast, kryetari i Komisionit Statutor në SBASHK, Blendor Shatri, bëri një prezantim mbi Ligjin për Grevat në Kosovë dhe sqaroi parimet bazë të tij. “Greva është një ndërprerje e përkohshme e punës nga punëtorët për realizimin e kërkesave ekonomike, sociale apo profesionale. Punëdhënësi dhe Sindikata janë të detyruar të sigurojnë shërbimet minimale gjatë grevës në sektorët si: shëndetësia, energjia, ujësjellësi, transporti publik, siguria etj.” u shpreh ndër të tjera Shatri.

Konferenca dyditore përmbledhi prezantime dhe shkëmbime të përvojave edhe nga vendet tjera të Rajonit.



Përfaqësuesit e SBASHK-ut qëndruan në një vizitë tre-ditore në Holandë SBASHK mori pjesë në Kongresin e Sindikatës së Arsimit “AOB” në Holandë



Përfaqësuesit e Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës së Kosovës – SBASHK, nënkryetarja Vjollca Shala dhe sekretari i Përgjithshëm Ymer Ymeri, gjatë muajit nëntor qëndruan për vizitë zyrtare në Holandë, ku morën pjesë në Kongresin e Sindikatës së Arsimit të Holandës “AOB”.



Ky Kongres mbledhi përfaqësues të shumë sindikatave arsimore nga Evropa dhe më gjerë, duke krijuar një hapësirë të rëndësishme për dialog, bashkëpunim dhe shkëmbim përvojash mbi sfidat dhe drejtimitet e arsimit publik.

Gjatë Kongresit pati pjesëmarrje dhe diskutime strategjike, ku delegacioni i SBASHK-ut ishte pjesë aktive e sesioneve tematike, diskutimeve të organizuara dhe takimeve me sindikata dhe institucione partnere.



Kongresi trajtoi çështje kyçe për të ardhmen e arsimit: mirëqenia e mësimdhënësve, financimi i arsimit publik, sfidat e kohës moderne në shkolla dhe roli i sindikatave në mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve të arsimit. Pjesëmarrja e SBASHK-ut në këtë Kongres përbën një hap të rëndësishëm në forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe shkëmbimit të përvojave me sindikatat evropiane.



Paraprakisht, delegacioni nga Kosova u prit të enjten nga udhëheqësit më të lartë të AOB, kryetarja Coba van der Veer dhe sekretari i përgjithshëm Willem Naus, ku zhvilluan një darkë të përbashkët në mbrëmje, e cila shërbeu si mundësi e shkëlqyer për të diskutuar mbi zhvillimet në arsimin publik, sfidat e përbashkëta të mësimdhënësve, si dhe rrugët e reja të bashkëpunimit ndërmjet dy sindikatave. Gjatë bisedës, u shkëmbyen përvoja rreth rolit të sindikatave në mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve të arsimit, ndikimit të tyre në politikat publike dhe përpjekjeve për ngritjen e cilësisë së arsimit.



Përfaqësuesit e SBASHK-ut, të premtën, kishin mundësi të vizitonin edhe shkollën “Child Center LEF”, ku u njohën nga afër me sistemin arsimor holandez. Gjatë kësaj vizite, nënkryetarja Vjollca Shala dhe sekretari i Përgjithshëm Ymer Ymeri u njohën me mënyrën se si funksionon shkolla, standardet pedagogjike, bashkëpunimin me prindërit dhe komunitetin, si dhe kushtet e punës së mësimdhënësve në këtë institucion. Përfaqësuesit e SBASHK-ut vlerësuan organizimin profesional, respektimin e të drejtave të punës dhe mbështetjen e vazhdueshme që AOb u ofron mësimdhënësve anëtarë. Pas vizitës në shkollë, delegacioni i SBASHK-ut, të premtën, po ashtu mori pjesë në një seminar dhe debat me fokus te sfidat e rekrutimit dhe mbajtjes së personelit të ri në sistemin arsimor. Ky diskutim, i organizuar në selinë e AOb, trajtoi problemet që po hasin aktualisht shumë shtete evropiane: mungesën e mësimdhënësve të rinj, presionet e rritura mbi stafin ekzistues dhe nevojën për përmirësimin e kushteve të punës për tërheqjen e kuadrove të reja. Përfaqësuesit e SBASHK-ut kontribuan në diskutim, duke sjellë perspektivën kosovare dhe përvojat nga terreni, duke nënvizuar sfidat me të cilat përballen mësimdhënësit e rinj dhe rëndësinë e politikave të qëndrueshme për zhvillimin profesional të tyre.



Të premtën, u zhvillua edhe ceremonia lamtumirëse për Sekretaren Ndërkombëtare të AOb, Trudy Kerperien, ku përfaqësuesit e SBASHK-ut shprehën mirënjohje të veçantë për bashkëpunimin e ngushtë ndër vite, mbështetjen e saj të çmuar dhe përkushtimin në avancimin e marrëdhënieve ndërkombëtare të SBASHK-ut. Ajo ka qenë një zë i rëndësishëm në promovimin e vlerave sindikale dhe të drejtave të mësimdhënësve në nivel evropian.

Vizita zyrtare treditore në Holandë u përmbyll më 23 nëntor, kur përfaqësuesit e SBASHK-ut u kthyen në Kosovë, duke sjellë me vete përvoja dhe ide të reja, që pritet të kontribuojnë në punën sindikale dhe avancimin e të drejtave të mësimdhënësve në vend.


TRAJNIMET

SBASHK vazhdoi me organizimin e trajnimeve për mësimdhënës edhe gjatë muajit nëntor

SBASHK organizoi 10 grupe trajnimi dhe tri teste për mësimdhënës gjatë muajit nëntor



Gjatë muajit nëntor, SBASHK-u ka vazhduar me organizimin e trajnimeve për mësimdhënës në dy programe të ndryshme të trajnimit, ato: “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” dhe “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social”, në të gjithë Kosovën.



Të shtunën, më 22 nëntor, SBASHK filloi me shtatë grupe trajnimi në disa komuna të Kosovës. Katër grupe trajnimi filluan në Prizren, dy grupe në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” – moduli 1 dhe moduli 2, të cilat po udhëhiqen nga trajnerët Naser Kastrati dhe Ermal Ahmetaj, respektivisht. Kurse një grup trajnimi në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social” po udhëhiqet nga trajneri i përcaktuar nga SBASHK, Gani Kryeziu.



Trajnimi në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” gjatë të njëjtit vikend kishte filluar edhe në komunën e Rahovecit, nën udhëheqjen e trajnerit të përcaktuar nga SBASHK-u, Emin Hoxha.



Ndërsa në Gjakovë filloi një grup trajnimi në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, të cilin po e udhëheq trajnerja e përzgjedhur nga SBASHK, Litvana Spahija.



Grupet e trajnimit të filluara në Gjakovë e Prizren gjatë vikendit të parë i kishte vizituar edhe zyrtari ligjor në SBASHK, Blendor Shatri, i cili ishte njoftuar nga afër me mbarëvajtjen e trajnimeve.



Gjatë takimeve me mësimdhënësit pjesëmarrës, Shatri ishte njoftuar me ecurinë e sesioneve, angazhimin e trajnerëve dhe interesimin e lartë të pjesëmarrësve për të forcuar aftësitë profesionale dhe teknologjike.

Shatri vlerësoi organizimin e trajnimeve dhe theksoi rëndësinë që këto programe kanë në zhvillimin profesional të mësimdhënësve dhe në përmirësimin e cilësisë së procesit mësimor.

Ndërkohë, një javë më parë, SBASHK-u kishte filluar edhe me tri grupe të tjera trajnimi.



Në Pejë, të dielën, më 16 nëntor, SBASHK kishte filluar me një grup trajnimi në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social”, nën udhëheqjen e trajnerit të përcaktuar nga SBASHK, Ilir Gashi.



Mësimdhënësit që e filluan trajnimin i kishte vizituar edhe kryetari i NSKAP-it për Pejë, Isuf Lajqi, i cili ishte kujdesur për mbarëvajtjen e fillimit të trajnimit dhe u kishte ofruar mbështetje mësimdhënësve në zhvillimin e tyre profesional. Po ashtu, gjatë të njëjtit vikend kishin filluar edhe dy grupe trajnimi në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”.



Një grup në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie – moduli 1” filloi në Mitrovicë, nën udhëheqjen e trajnerit të përcaktuar nga SBASHK, Kadri Hyseni, kurse grupi tjetër në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie – moduli 2” filloi në Viti, nën udhëheqjen e trajnerit të përzgjedhur nga SBASHK, Musli Neziri.



Gjithashtu, gjatë muajit nëntor, SBASHK ka organizuar edhe tri teste për mësimdhënësit, të cilët e kishin përfunduar trajnimin në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, në tri komuna të ndryshme të Kosovës. Në Kaçanik u mbajt testi për një grup të mësimdhënësve, nën administrimin e nënkryetares së SBASHK-ut, Vjollca Shala, derisa trajneri që e kishte udhëhequr këtë grup të trajnimit ishte Naser Guri. Gjatë mbajtjes së testit, i pranishëm ishte edhe kryetari i NSKAP-it për Kaçanik, Islam Berisha, i cili u kujdes për mbarëvajtjen e testimit, i cili u mbajt në shkollën “Emin Duraku”.



Paraprakisht, testi ishte mbajtur edhe për një grup të mësimdhënësve në Rahovec, i cili ishte udhëhequr nga trajneri i përcaktuar nga SBASHK, Albert Samadraxha. Testi ishte administruar nga sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri, dhe zyrtari ligjor, Blendor Shatri. Ndërsa për të përcjellë nga afër mbarëvajtjen e testit, të pranishëm ishin kryetari i NSKAP-it për Rahovec, Mehmet Kryeziu, nënkryetarja Elife Maxhuni-Hoti, si dhe ish-kryetari i NSKAP-it, Veli Morina.



Ndërsa, qysh në fillim të muajit nëntor, testi për një grup të mësimdhënësve, të cilët e kishin ndjekur trajnimin në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, nën udhëheqjen e trajnerit Fejzullah Berisha, ishte organizuar edhe në Drenas. Testi në Drenas ishte administruar nga sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri, dhe zyrtarja Nezafete Jakupi. Kurse, për të përcjellë nga afër mbarëvajtjen e testit, i pranishëm ishte kryetari i NSKAP-it për Drenas, Ilaz Dervishi.



SBASHK vazhdon organizimin e trajnimeve për mësimdhënësit, anëtarë të Sindikatës, në çdo komunë të Kosovës.

AKTIVITETE TË TJERA

SBASHK mori pjesë në takimin e DKA-së në Prishtinë, me drejtorët e shkollave



Pavarësisht mungesës së vullnetit për dialog nga institucionet qendrore, përkatësisht Qeveria dhe MASHTI,

SBASHK-u po vazhdon të organizojë rregullisht takime në nivel lokal, në interes të punëtorëve arsimorë. Një takim i tillë ishte mbajtur gjatë muajit nëntor me përfaqësues të Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA) në Prishtinë dhe me drejtorët e institucioneve arsimore të kryeqytetit. SBASHK-u mori pjesë në këtë takim me ftesë të drejtorit të Arsimit në Prishtinë, z. Samir Shahini, ku të pranishëm ishin edhe drejtorët e shkollave të Prishtinës. Në takim, SBASHK-u ishte përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm, z. Ymer Ymeri, zyrtari ligjor, z. Blendor Shatri, dhe Kryetari i NSKAP-it për Prishtinë, z. Qamil Hajdini.



Përfaqësuesit e SBASHK-ut në këtë takim kishin marrë pjesë në cilësinë e vëzhguesve dhe kishin dhënë kontributin e tyre në diskutimet për disa çështje me interes për arsimin. Gjatë takimit ishte diskutuar për:

- mundësinë e udhëtimit pa pagesë të mësimitdhënësve me Trafikun Urban,
- përgatitjet për buxhetin e vitit të ardhshëm, si dhe
- njoftimet lidhur me shkollat që do të përfshihen në mësimin gjithëditor.

SBASHK përkrah fuqishëm protestën e Sindikatës së Punëtorëve të RTK-së (SPERTK)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK) shpreh përkrahjen e plotë dhe të palëkundur për Sindikatën e Punëtorëve të RTK-së (SPERTK) dhe për të gjithë punëtorët e këtij mediumi publik, të cilët, përmes dialogut e veprimeve sindikale, po kërkojnë një të drejtë themelore, sigurimin e pagave të tyre të merituar.

SBASHK-u ka ndjekur me vëmendje situatën e krijuar në RTK dhe shpreh shqetësimin e thellë për faktin se, më 12 nëntor 2025, punëtorët e RTK-së ende nuk kanë marrë pagat e muajit tetor. Kjo gjendje është e papranueshme dhe përbën cenim të drejtpërdrejtë të dinjitetit të punëtorit.

SBASHK-u i bën thirrje urgjente Qeverisë në detyrë që të gjejë menjëherë zgjidhje dhe të alokojë mjetet e nevojshme për pagesën e pagave, jo vetëm për muajin tetor, por edhe për muajt në vijim, në mënyrë që të garantohet funksionimi normal i RTK-së dhe mirëqenia e punëtorëve të saj.

Në emër të SBASHK-ut, fjalën përshëndetëse e kishte mbajtur sekretari i Përgjithshëm, z. Ymer Ymeri, i cili kishte falënderuar drejtorin e DKA-së, z. Samir Shahini, për bashkëpunimin e mirë me SBASHK-un, si dhe kryetarin e Komunës së Prishtinës, z. Përparim Rama, për mundësinë që punëtorët e arsimit të udhëtojnë falas përmes Trafikut Urban.

Z. Ymeri kishte përgëzuar DKA-në që, pavarësisht sfidave me mosmiratimin e buxhetit nga Kuvendi, Komuna e Prishtinës kishte arritur të funksionojë me buxhetin e vitit të kaluar dhe t'i realizojë të gjitha planifikimet e parapara. “Urojmë që ky bashkëpunim i mirë të vazhdojë në të njëjtin nivel edhe në javët dhe muajt në vijim”, kishte thënë z. Ymeri.

Ai kishte theksuar gjithashtu se SBASHK-u mbështet mësimin gjithëditor, veçanërisht në rastet kur mësimitdhënësit nuk kanë angazhim shtesë. Në ato raste kur ka angazhim shtesë, sipas tij, ai duhet të paguhet si mbinormë, gjë që njëkohësisht kontribuon në ruajtjen e vendeve të punës në arsim.

Po ashtu, SBASHK-u shpreh indinjatën e thellë ndaj çdo forme presioni që, sipas raportimeve, po ushtrohet mbi punëtorët e RTK-së. U bëjmë apel drejtuesve të këtij institucioni publik që të ndalojnë menjëherë çdo presion ndaj të punësuarve dhe të bëhen zëri i tyre për kërkesën më bazike, pagën për punën e ndershme që kryejnë çdo ditë në shërbim të publikut.

Në shenjë solidariteti dhe përkrahjeje sindikale, Kryesia e SBASHK-ut do të marrë pjesë në protestën e nesërme të organizuar nga Sindikata e Punëtorëve të RTK-së.

Gjithashtu, SBASHK-u nuk përjashton mundësinë që, nëse kjo situatë vazhdon, të mobilizojë të gjithë anëtarësinë e saj, nga çerdhet e deri në universitete, për t'u solidarizuar me kolegët e RTK-së, sepse solidariteti ndërmjet punëtorëve është shtylla më e fortë e lëvizjes sindikale.

SBASHK-u do të jetë gjithmonë në krah të çdo punëtori që lufton për dinjitetin dhe të drejtën e tij.